



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË  
SEKTORI I FINANCËS DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Nr. 65 Prot.

Tiranë, më 17 . 01 .2024

Lënda: Njoftim për vend të lirë pune

Në zbatim të Vendimit nr. 109, datë 15.02.2017 të Këshillit të Ministrave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë e të Bordit të Akreditimit dhe për përcaktimin e tarifave për proceset e sigurimit të cilësisë në Arsimin e Lartë” i ndryshuar, Urdhërin e Kryeministrit Nr.20, datë 26.01.2021 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë”, dhe në VKM Nr.143 datë 12.03.2014 “Për procedurat e rekrutimit, të përzgjedhjes, të periudhës së provës, të levizjes paralele e të ngritjes në detyrë për nëpunësit civil të kategorisë ekzekutive, të ulët e të mësme drejtuese”, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL), shpall njoftimin për 1 (një) vend të lirë pune në pozicionin e **Specialist Arkiv/Protokolli**.

Të interesuarit duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

**I. Kërkesa të përgjithshme për kandidatin:**

1. Të ketë përfunduar arsimin e lartë dhe të zotërojë një diplomë universitare të ciklit të dytë ose ekuivalent me të, vërtetuar me diplomën përkatëse.
2. Preferohen kandidatë të cilët kanë përvojë pune në profesion që ka lidhje me pozicionin e shpallur, si dhe kandidatët që kanë përvojë pune në arsimin ose që kanë lidhje me arsimin e lartë.
3. Të njohë legjislacionin mbi Arkivat.
4. Të prezantojë etikë, qytetari dhe nivel performance të denjë për institucionet e administratës publike.
5. Të ruajë sekretin kofidencial të shkresave në institucion.
6. Të zotërojë gjuhën angleze, me dëshmi në nivel të avancuar.

**II. Kërkesa të veçanta për kandidatin:**

1. Të ketë njohuri të mira kompjuterike në programet bazë dhe të avancuara.
2. Preferohen kandidatë që kanë njohuri për legjislacionin bazë të arsimit të lartë dhe njohuri mbi institucionet, programet e studimit, procedurat, kriteret dhe aktet nënligjore të sistemit të akreditimit.
3. Të ketë integritet të lartë profesional e moral.
4. Të ketë aftësi për të krijuar marrëdhënie pune efektive me stafin e Ascal.
5. Të ketë dhe dëshmojë aftësi komunikuese për të punuar në grup.

Adresa: Rruga e Durrësit, Nr. 219, Tiranë; Tel: +355(0)2243423/2266203;  
web: [www.ascal.al](http://www.ascal.al); e-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)

6. Të ketë dhe dëshmojë aftësi të mira shkrimi dhe komunikuese.
7. Të ketë të paktën tre vite eksperiencë profesionale ose çdo lloj përvojë tjetër profesionale që lidhet me vendin e shpallur.

### III. Dosja e aplikuesit duhet të përmbajë:

1. Jetëshkrimin (*Curriculum vitae*)
2. Kërkesën me shkrim dhe kontaktin personal
3. Diplomën dhe listën e notave të noterizuar
4. Dëshmi të kualifikimeve pasuniversitare të kryera apo në proces
5. Fotokopjen e librezës së punës; e noterizuar
6. Dëshmia e gjuhës angleze/huaj e noterizuar
7. Fotokopje të dëshmive të kualifikimeve të kryera, të noterizuara
8. Vlerësime pune nga punëdhënësi/t e mëparshëm.
9. Vërtetimin e Gjendjes Gjqësore

*Vlerësimi i kandidatëve do të bëhet me sistem pikëzimi, mbi bazën e dokumentacionit, njohjes së aftësive kompjuterike dhe gjuhës së huaj të shkruar dhe folur, dhe përmes një interviste në prani të një komisioni të ngritur posaçërisht për këtë qëllim.*

Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë ASCAL dosjen me dokumentacionin e kërkuar deri më datën 25.01.2024, ora 16;30 në adresën e mëposhtme;

**Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë.  
Rruga e Durrësit, pranë Gjimnazit "Qemal Stafa"  
Tel: 4 22 43 423**

- *Njoftimi të bëhet edhe në ëeb site e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë:  
[www.ascal.al](http://www.ascal.al)*

### DREJTOR I PËRGJITHSHËM

XBY  
**Xhiliola Bixheku**



---

Adresa: Rruga e Durrësit, Nr. 219, Tiranë; Tel: +355(0)2243423/2266203;  
web: [www.ascal.al](http://www.ascal.al); e-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)